



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i Dëgjimit Publik për Buxhetin 2022/2023 Fshati Gllamnik

Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ishte ai i cili e hapi këtë dëgjim publik, që u mbajtë në fshatin Gllamnik të Komunës së Podujevës. Osmani theksoi se ky dëgjim po mbahet për të diskutuar buxhetin e vitit 2023. Ku tashmë Komuna e Podujevës është në fazën e hartimit të buxhetit për vitin 2023.

Buxheti këtë vit do të jetë 27. 406.566, që është buxheti më i madh në historinë e Komunës së Podujevës dhe është 4 milion euro më i madh se vitin e kaluar.

Ky buxheti i vitit 2023 përfshinë të gjitha kategoritë, dhe në të gjitha këto kategori ka rritje të buxhetit. Prioritet në këtë buxhet Komuna e Podujevës i ka: kategorinë e pagave, atë të mallrave, kategorinë e shërbimeve, kategorinë e investimeve kapitale dhe atë të subvencioneve.

Drejtori Osmani thekson se ka rritje në të gjitha kategoritë duke veçuar: investimet kapitale me një rritje afër 2 milionë euro, kategoria e subvencioneve e cila do të arrijë shumën 1 milionë e 600 mijë euro, dhe fusha e bujqësisë e cila nga 430 mijë euro do të arrijë deri në 700 mijë euro.

Sepse pa dyshim që këto do të janë ndihmesë e madhe për të gjitha fshatërat pa dallim, dhe sidomos do të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe shoqërorë.

Osmani poashtu vë në dukje faktin se arsyeja e kësaj mbledhje sot është që të merren edhe qëndrimet e qytetarëve të Komunës së Podujevës në atë mënyrë që ato të mund të inkuadrohen pastaj në buxhetin e vitit 2023.

Buxheti i vitit 2023 spjegon Osmani se padyshim që nuk do të arrijë t'i përmbushë të gjitha nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, po prioritet i Komunës së Podujevës do të jenë disa qështje më prioritare.

Së bashku me një falenderim Drejtori Osmani ua kalon fjalën qytetarëve.

Osman Bahtiri, përfaqësues i fshatit Gllamnik – “ si fillim shpreh kënaqësinë e tij ne lidhje me punën që është zhvilluar në fshatin ku jeton, por prioritet në fshatin tonë janë kanalizimet të cilat

kanë mbetur pa përfunduar nga projektet e viteve të kaluara thotë ai. Përshembull në një pjesë janë rregulluar 150 metra dhe kanë mbetur pa përfunduara edhe 170 – 180 metra të tjera. Dhe ka edhe shumë raste të tjera të cilat gjysma e lagjës ka kanalizim dhe gjysma tjetër nuk ka fare. Pastaj është e rëndësishme dhe rregullimi i urës së fshatit Gllamnik, e cila ka filluar ndërtimin në vitin e kaluar dhe për fat të keq ka mbetur në gjendje të mjerueshme. Ndërsa sa i përket infrastrukturës ka disa shtëpi në fshatin Gllamnik të cilave u mungon infrastruktura rrugore e asfaltuar. Nuk janë rrugë të gjata por kanë qenë në projekt qe katër vite, me participim nga banorët e fshatit, por ato prapë kanë mbetur të papërfunduara dhe banorët po ankohen. Poashtu edhe një urë mbi lumin Llap thotë përfaqësuesi i fshatit, për nevojat e bujqëve që punojnë tokën. Dhe poashtu tri rrugë të cilat kërkohen që të bëhen shtrime vetëm më zhavor, është e mjaftueshme. Dhe disa rrugë të tjera të cilat janë të papërfunduara. Dhe si përfundim këkohet elektrifikimi i disa rrugëve të cilave u mungon, për aryse që mungesa e tyre po ua vështirësonë banorëve të fshatit lëvizjen gjatë natës. Poashtu problem është edhe mungesa e ujit të pijshëm në një pjesë të fshatit dhe poashtu është e nevojshme një qerdhe për fëmijë, dhe një sallë për edukatë fizike.”

Banor i fshatit Gllamnik – “kërkon nga Komuna e Podujevës që të shtojnë buxhetin për vitin tjetër edhe për pastrimin e lumit Llap, pasi që kundërmon shumë erë dhe është e padurueshme. Dhe poashtu identifikimin e të gjithë banorëve të cilët poi hudhin mbeturinat buzë lumit dhe buzë rrugës. “

Fahri Mahmuti, përfaqësues i fshatit Siboc i Epërm – “ tregon që ka mungesë të trotuareve në fshatin Siboc, sepse pjesa e trotuarëve është bërë e pakalueshme, dhe vështirësitë më të mëdha po i kanë nxënësit për në shkollë, sidomos gjatë stinëve të ftohta me shi dhe borë. Poashtu një nevojë tjetër është edhe ndriqimi i cili mungon në disa pjesë të fshatit dhe rregullimi i një hapsire në mënyrë që të shfrytëohet si hapsirë për varrezat. Një sallë sportive në oborrin e shkollës poashtu do të ishte e nevojshme.”

Banor i fshatit Gllamnik – “ shpreh kërkesën e tijë në lidhje me mungesën e një qerdheje, poashtu ndërtimi i ambullantës dhe fushës sportive ka qenë shkaktarë i grumbullimit të ujit para shtëpisë në të cilën ai banorë jeton dhe kërkon që të bëhet një zgjidhje duke shtuar se ka bërë kërkesë me shkrim për shtrimin e asaj pjese në kocka. Duke kërkuar më tutje largimin e ujërave të zeza nga lumi Llap. “

Banor i fshatit Gllamnik – “ kërkesë për kadastër, në mënyrë që të lirohen nga pagim tatami për kotecë dhe objektet e tjera për nevoja vetanake në oborret e shtëpisë së tyre.”

Përfaqësues i fshatit Konushec, Fadil Berisha – “ shpreh pakënaqësitë e tijë në lidhje me mungesë të asfaltimit në disa rrugë të Konushefcit, duke shtuar se janë bërë edhe kërkesa me shkrim. Një kërkesë tjetër është edhe ndriqimi, i cili mungon në një pjesë të fshatit, dhe në një lagje një javë pas vendosjes së dritave ato kanë rënë nga përdorimi. Një problem tjetër që e shtoi përfaqësuesi është edhe mungesa e ujit të pijshëm që tash e 13 vite.

Përfaqësues i lagjes së Bajgorëve – “ si kërkesë për lagjen e tijë ka vendosjen e gypave që bëjnë përcjelljen e ujit gjatë stinëve të ftohta dhe poashtu ndërtimin e trotuarëve. Pastaj është edhe ndërimi i shtyllave elektrike për shkak të vjetrimin të shtyllave ekzistuese. Dhe për disa vite me rrdhë lagjaia ka pasë kërkesë për asfaltimin e tri rrugëve. Kërkesë tjetër është edhe ndërtimi i një ure që na e lehtëson bartjen e ushqimit për bagëti. Dhe rruga që lidhë fshatin Konushec dhe atë Penuh ka nevojë për asfaltim e cila është një rrugë e mbuluar me therra dhe ka kërkesa që janë bërë dhe më herët në lidhje me këtë qështje. Është e rëndësishme përfundimi i një pjese të trotuarit që ka mbetur pa përfunduar.

Xhevdet Avdullahu, përfaqësues i lagjes së Krtollëve – “shpreh kërkesë urgjente rregullimin e kanalizimit, pastaj rruga dhe ndriqimi, por gjithmonë duke pasur prioritet kanalizimin.”

Bahri Selimi, Drejtori për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim u përgjigj të gjithë kërkesave për trotuare, duke thekësuar se ka projekte që mbulojnë shtrimin e trotuarëve por që nuk ka mundësi të realizohen të gjitha kërkesat pasi që ka fshatëra të cilat nuk kanë fare ose kanë shumë pak rrugë me trotuare.

Sa i përket kanalizimeve shton Selimi se Komuna e Podujevës ka të inicuar një projekt i cili pritet të nënshkruhet, poashtu për disa kanalizime te lagjia e Zhegrove dhe ajo te Kosumovit problemi i kanalizimit pritet të zgjidhet me projekt, për shkak të pozitës jo shumë të mirë gjeografike që kanë ata banorë. Poashtu prioritet është edhe kanalizimi i lagjës së Sekiraqëve, dhe poashtu në lagjen Sylja ka një projekt që është në fazën e prokurimit.

Kërkesës për ura i përgjigjet Drejtori Osmani se ka pasur ngecje nga kontraktori i cili nuk e ka përfunduar punën e tijë si duhet, por tashmë Komuna e Podujevës ka nënshkruar kontratë të re dhe brenda 10 ditëve përafërsisht dy javëve pritet të fillojnë punimet për rregullimin e këtyre urave.

Ndërsa rruga që lidhë fshatin Penuhë dhe atë Konushec pritet që të fillojë shumë shpejt punimet, ndërsa sa i përket ndriqimit publik për këtë vit nuk ka projekt, ndërsa për vitin e ardhshëm ka buxhet mbi 110 mijë euro edhe për këtë pjesë.

Një projekt të cilën banorët nuk e shtruan si qështje dhe që Komuna e ka në projekt për vitin 2023 spjegon Bahri Selimi është edhe rrethimi i varrezave.

Poashtu rreth lumit është paraparë edhe një muri mbrojtës dhe pastaj edhe rregullimi me zhavor. Poashtu për vitin tjetër pritet të rregullohet edhe ura sepse Komuna ka të ndarë mbi 200 mijë euro buxhet për rregullimin e urave.

Në mes ambullantës që po ndërtohet dhe fushaës është paraparë të bëhet një rrugë me kubëza.

Sa i përket varrezave tek lagja e Bajgorëve, është marrë vendim për vendosjen e gypave të cilët e largojnë ujin nga varrezat,

Problemit të papastërtisë në lumin Llap Drejtori Selimi u përgjigj duke treguar projektin që kanë bërë në fund të vitit të kaluar që ka përfunduar një pjesë bukur të mirë në pastrim. Por tashmë janë paraparë edhe 230 mijë euro në buxhet dhe punimet mbi këtë problematikë do të fillojnë të hënën. Por nuk trajtohet i gjithë shtrati i lumit, por vetëm disa pjesë që kanë ndjeshmëri më të madhe.

Dhe kërkesës për ndërrimin e shtyllave e shpjegon Drejtori Selimi se nuk është projekt i Komunës por është projekt i KEDS-it.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani kërkonë nga banorët e Komunës së Podujevës që të gjitha këto kërkesa t'i përcjellin edhe me shkrim, në mënyrë që Komuna të jetë sa më gjithëpërfshirëse në këtë planifikim të buxhetit.

Korniza Buxhetore e vitit 2023 spjegon Drejtori Osmani se i ka në buxhet të planifikuara 10 mijë euro për asfaltimin e rrugëve. Ky projekt është në fazën e prokurimit dhe pothuajse është gati të nënshkruhet kontrata. Kjo kontratë parasheh afër 140 mijë euro për ndërtimin e rrugëve.

Poashtu ka shumë investime edhe në kanalizime, në shtratin e lumenjëve që Komuna për tri vite ka ndarë buxhet rreth 1 milionë e 600 mijë euro investime vetëm për trajtimin e këtyre problemeve. Duke shpresuar se me këto investime do të zgjidhet përfundimisht problem i ujërave të zeza.

Komuna ka edhe projekte madhore që është ai i ndërtimit të kolektorit që kushton rreth 20 milionë euro, ku pritet të përfundoj aplikimi sepse Komuna e Podujevës nuk ka kapacitet për rregullimin e këtij projekti, prandaj pritet që vitet në vazhdim të fillojnë punimet.

Poashtu të gjitha këto shqetësime që u paraqitën këtu do të trajtohen në buxhetin e vitit 2023.

Ndërsa sa i përket investimeve në arsim, Drejtori Osmani jep informacion se vitin e ardhshëm do të ketë 15 fishim të buxhetit i cili nga shuma prej 114 mijë euro ka arritur vlerën 1 milionë e 660 mije euro.

Fusha e bujqësisë ka rritje të buxhetit nga 420 mijë euro në 700 mijë euro. Poashtu fusha e kulturës ka një 5 fishim të buxhetit ku nga 40 mijë sa kanë qenë, ka arritur vlerën deri në 200 mijë euro. Poashtu në fushën e zhvillimit ekonomikë ka projekte madhore siç është zona industriale, subvencionimi për kreditë investive, subvencione për biznese fillestare, ku do të ketë afër 300 mijë euro subvencione në fushën e ekonomisë.

Së bashku me Ministrinë shton Drejtori Osmani se janë në proceset e fillimit të ndërtimit të dy qerdheve, të cilat janë në fazën e prokurimit, por me shpresën që do të fillojnë edhe ndërtimin e një qerdheje të tretë.

Si përfundim Drejtorin Osmani vë në dukje faktin se përveç që ka diskutime publike drejtorët janë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, dhe Komunan e Podujevës vazhdon të jetë e informuar mjaftë mirë për të gjitha problemet që ka qyteti dhe fshatërat që i përkasin.

Komuna e Podujevës ka bërë një kërkesë në Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e fushave sportive, në mënyrë që ky projekt të llobohet në projektin e Ministrisë së Arsimit, në rast se nuk përfshihet në buxhetin e Ministrisë së Arsimit ne do të bëjmë përpjekje që ta inkuadrojmë atë në buxhetin e Komunës por jo në vitin 2023. Krejt kjo për shkak të projekteve të tjera siç është digjitalizimi i shkollave, që mendohet se është shumë e rëndësishme, përfshirë këtu edhe investimeve të tjera.

Ndërsa kërkesës për mbledhjen e mbeturinave i Përgjigjet drejtori Selimi, duke shpjeguar se kjo kërkesë i përgjigjet Kompanisë Pastruese “Pastrimi” por edhe Komuna është aksionare. Problem qëndron tek mungesa e makinerisë e cila është e pamjaftueshme. Shkaktarë i krejt kësaj parregullësie është edhe mos kyqja e ekonomive familjare në sistem të pagesave.

Komuna e Podujevës vetëm këtë vit ka hargjuar rreth 50 milionë euro për largimin e deponive ilegale të mbeturinave.

Komuna e Podujevë po bënë përpjekje për futjen e të gjithë banorëve të Komunës në sistemin e pagesave. Poashtu Komuna ka krijuar një rregullore të re e cila i obligon të gjitha shtëpitë të paguajnë marrjen e mbeturinave dhe kjo do të bëjë eliminimin më të shpejtë të kësaj problematike. Sepse nga 35 mijë familje që janë të regjistruara në Komunën tonë, vetëm 10 mijë janë të kyqura në këtë sistem.

Sa i përket ujit të pijshëm Komuna ka një konflikt të kompetencave me KRU Prishtinën, sepse përgjegjësi kryesor i kësaj qsjtje është vetë KRU Prishtina. Tshme kemi bashkëpunim me ta dhe jemi në përpjekje për të gjetur një zgjidhje më të mirë për ujin. Problem të tilla me ujin kanë edhe fshatërat tjera si Bollopoja, Gllamniku e fshatëra të tjera.

Kështu Drejtori Osmani e përmbyllë këtë dëgjim publik duke i falenderuar të gjithë banorët për pjesëmarrje.

13 gusht, Podujevë.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Data: 12.08.2022

Ora: 17:00

Debati publik lista e nënshkrimeve për Buxhetin e vitit 2023

Lista e pjesëmarrësve

Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
Sadet	Abdullahu	Gllanrit	
Behar	Abdullahu	Gllanrit	
Faokll	Ben'din	Kumudhe	
AGI'14	SYLA	Gllanrit	
NASER	LALA	Gllanrit	
FATIRYPIH	MAMUTI	CIBOCIGËRË	
HeKumei	Jyle	Gllanrit	
Agam	Rajunij	Gllanrit	
Therap	Komun	Gllanrit	
Vail	Yhala	Kumudhe	
OSMANU	BATIRI	Pod. Pr. Gllanrit	
XHerde	Abdullahu	Gllanrit	

